

## Raport për rezultatet e konsultimeve publike

### 1. Titulli i draft aktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”

### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Në Ministrinë e Brendshme, më datë 25.01.2023, është zhvilluar mbledhja e pare e grupit ndërinstitucional të punës, e kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2022 “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrimit Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.

Më pas grupi i punës është mbledhur dhe në datë 9 shkurt 2023 dhe 23 mars 2023 për identifikimin e grupeve të interesit dhe përcaktimit të metodave të konsultimit.

Në datë 5 tetor 2023 akti ka kaluar për mendim nëpërmjet sistemit të e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjithashtu, është dërguar për mendim nëpërmjet emailit të datës 15 shtator 2023 pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Qendrës Kombëtare të Biznesit, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Postës Shqiptare sh.a, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Gjithashtu, është parashikuar edhe publikimi në RENJK për periudhën 26 tetor 2023 deri në 26 nëntor 2023, në respektim të afateve ligjore.

### 3. Metoda e konsultimit

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar” janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit nr. 66, datë 16.05.2023 të Ministrit të Brendshëm dhe një takim me grupin ndërinstitucional të punës në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2022 “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrisë Kombëtare të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

#### 4. Palët e interesit të përfshira

*Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:*

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme,
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

#### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

*Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

<b>Çështja e adresuar</b> (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	<b>Komenti</b> (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	<b>Palët e interesuara</b> (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	<b>Vendimi</b> (I pranuar I pranuar pjesërisht I refuzuar)	<b>Justifikimi</b>
<b>Neni 1</b> Është propozuar emërtimi i nenit 1	Për ndryshimet e propozuara në këtë	Shoqata e Këshillave	Vendimi i pranuar	Në përmbajtje të tekstit të projektligjit janë reflektuar sugjerimet e dhëna nga palët e interesuara, Shoqata e Këshillave

<p>të ligjit sipas titullit “Qëllimi”</p> <p>Në nenin 1, togfjalëshi “së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore”, është propozuar të zëvendësohet me togfjalëshin “juridiksionit të bashkisë” dhe në fund të fjalisë është propozuar të shtohet togfjalëshi: “të integruar në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA)”. Sipas pikës 3 të nenit 1 të projektligjit gjithashtu është propozuar se: Kudo në ligj togfjalëshi “së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore”, zëvendësohet me togfjalëshin “juridiksionit të bashkisë”. Sipas nenit 1, pika 4 të projektligjit që ndryshon nenin 1 të ligjit kudo në ligj togfjalëshi “seksionet/zyrat e urbanistikës”,</p>	<p>dispozitë ka patur komente nga palët e ndryshme të interesuara së bashku, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit</p>	<p>të Qarqeve të Shqipërisë</p> <p>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</p> <p>Në përmbajtje të projektligjit është reflektuar sugjerimi i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve</p>		<p>të Qarqeve të Shqipërisë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.</p>
--	--	--	--	--

<p>zëvendësohet me togfjalëshin “strukturat përgjegjëse në autoritetet e territorit në nivel bashkie, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore”.</p>		<p>të Shqipërisë për zëvendësim in kudo në ligj të togfjalëshit “seksionet/zyrat e urbanistikës”, me togfjalëshin “strukturat përgjegjëse në autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel bashkie si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore”, referuar parashikim eve në nenin 5 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.</p>		
--	--	---	--	--

		<p>Nëpërmjet mendimit të dhënë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike është dhënë mendim për zëvendësimin e togfjalëshit “planifikim in e territorit”, me togfjalëshin “planifikim in dhe zhvillimin e territorit”, sugjerim i dhënë në përputhje me ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.</p>		
<b>Neni 1/1</b>	Për këtë dispozitë janë dhënë sugjerime nga	Për përmbajtjen e kësaj	Vendimi i pranuar.	Vetëm për sa i përket formulimit për Kodin Unik, i cili krahas përkufizimit të dhënë nga AKSHI është shtuar dhe me

<p>Sipas nenit 2 të projektligjit propozohen shtesa dhe ndryshime në nenin 1/1 të aktit në fuqi, sipas përmbajtjes: Në nenin 1/1, bëhen këto shtesa dhe ndryshime: “1. Ky nen emërtohet me titullin “Përkufizime”; 2. Në pikën 1, pas fjalës “adresa”, shtohet togfjalëshi “është një seri informacioni i standardizuar që” dhe hiqet togfjalëshi “dhe shenja ortografike”. 3. Në pikën 2, në fillim të fjalisë shtohet togfjalëshi “zonë e qarkullimit civil është”. 4. Në nenin 1/1, shfuqizohet pika 3. 5. Pika 4 ndryshon si vijon: “Regjistri Kombëtar i Adresave”, në vijim RKA, është baza e vetme e të dhënave</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)-t.</p>	<p>dispozite nuk ka patur palë të tjera të interesuara, përveç Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)-t. Është sugjeruar saktësimi i togfjalëshit “adresë në ofrimin e shërbimeve publike”, të parashikuar në pikën 8, pasi ka mospërputhje me përcaktimet ligjore të pikës 20, të nenit 4, të ligjit nr.43/2023 “Për qeverisjen elektronike”.</p>		<p>pjesën e formulimit nga DPGJC, “që shërben për të identifikuar në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese, hyrje, apartamenti në brendësi të saj, në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA)”, për t’i dhënë një kuptim më të qartë këtij elementi që njëkohësisht ishte në thelb të iniciativës për ndryshimin e ligjit për adresat.</p> <p>Për këtë dispozitë gjithashtu nuk është reflektuar propozimi i AKSHI-t për sugjerimin në lidhje me saktësimin e togfjalëshit “adresë në ofrimin e shërbimeve publike”. Parashikimet sipas nenit 4, pika 20 të ligjit nr.43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, sanksionojnë përkufizimin e konceptit “ofrim i shërbimeve elektronike”, i cili në kuptim të këtyre dispozitave i referohet ofrimit të shërbimit në formën e dërgimit dhe marrjes së të dhënave përmes sistemeve TIK, me kërkesë individuale të përdoruesit, pa qenë i pranishëm fizikisht.</p> <p>Sipas argumentimeve të dhëna në tekstin e relacionit Pikat e Interesit (PI) në kuptim të këtij ligji përbëjnë një adresë me interes në ofrimin e shërbimeve bazë publike për shtetasit, siç janë ato arsimore, të shëndetësisë, kulturore, të transportit, të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, të rendit, ato turistike, etj. Ofrimi i këtij shërbimi do të jetë i hapur ndaj të gjithë shtetasve për të marrë informacion në kohë reale për shërbimet bazë publike.</p> <p>Në tekstin e projektligjit të dërguar për bashkërendim, për Pikat e Interesit (PI)</p>
--	---	---	--	--

<p>shtetërore, në të cilin regjistrohen dhe përditësohen të dhënat për adresën, sipas elementëve të saj, për çdo ndërtesë, apartament dhe truall të lirë.”</p> <p>6. Pas pikës 4, shtohen pikat 5, 6, 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:</p> <p>5. “Tabela e emërimit” është treguesi fizik i emërimit të zonës së qarkullimit civil”.</p> <p>6. “Tabela e numërimit” është treguesi fizik i numërimit të brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesës në zonën e qarkullimit civil”.</p> <p>7. “Kodi unik i adresës”, është një vlerë unike që përkon me elementët përbërës së adresës që shërben për të identifikuar në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtesë, hyrje, apartamenti</p>				<p>jepet ky përkufizim: “Pika e Interesit (PI)”, është vendndodhje specifike me interes publik, e shprehur në RKA nëpërmjet adresës së saj”.</p>
---	--	--	--	--

<p>në brendësi të saj, në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA)”. 8. “Pika e interesit (PI)”, është një adresë me interes në ofrimin e shërbimeve publike”.</p>				
<p><b>Neni 2</b> Sipas nenit 3 të projektligjit në pikën 1, është propozuar emërtimi i kësaj dispozite të paemërtuar në variantin aktual të ligjit me titullin “Elementët e adresës”. 2. Në pikën 1, pas fjalës “vendndodhjen”, është propozuar të shtohet togfjalëshi “në terren”. 3. Në shkronjën d), të pikës 1, është propozuar të hiqet togfjalëshi “<i>bulevardit/rrugës /rrugicës/parkut ose sheshit</i>”. Pas pikës 2, është propozuar të shtohet pika 3, me përmbajtjen: “<i>Algoritmi dhe</i></p>	<p>Nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është dhënë sugjerim lidhur me pikën 7 që i referohet përcaktimit për përkufizimin e konceptit të Kodit Unik. Sipas parashikimit fillestar “Kodi unik”, është një vlerë unike, që përkon me elementët përbërës së adresës”.</p>	<p>Për këtë dispozitë janë dhënë sugjerime nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)-t.</p>	<p>Vendimi i pranuar pjesërisht</p>	<p>Në vijim të sugjerimit të AKSHI-t, ky sugjerim është plotësuar sipas këtij formulimi: “Kodi unik i adresës”, është një vlerë unike që përkon me elementët përbërës së adresës që shërben për të identifikuar në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese, hyrje, apartamenti në brendësi të saj, në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA)”. Formulimi për konceptin, përkufizimin e Pikave të interesit (PI), mbetet i njëjtë. Pika e interesit është vendndodhje specifike me interes publik, e shprehur në RKA nëpërmjet adresës së saj.</p>



<p><i>struktura e kodit unik të adresës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</i></p>				
<p><b>Neni 3</b> Sipas nenit 4 të projektligjit është propozuar emërtimi i nenit 3 ekzistues të ligjit me me titullin: “Organet përgjegjëse për emërtimin dhe numërtimin” dhe sipas pikës 2 gjithashtu është propozuar që togfjalëshi “këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të zëvendësohet me togfjalëshin “këshillit të bashkisë”.</p>	<p>Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë</p>	<p>Për ndryshimin sipas pikës 2 të nenit 4 të projektligjit është reflektuar sugjerimi i dhënë nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë në kuadër të unifikimit të terminologjisë në mënyrë që togfjalëshi i përdorur vetëm një herë në ligj “këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të zëvendësohet me togfjalëshin</p>	<p>Vendimi i pranuar</p>	

“këshillit të bashkisë”.

Në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004

“Për sistemin e adresave”,

të ndryshuar,

termi

këshillit të njësisë të

vetëqerisisj

es vendore

përdoret

vetëm 1

(një) herë,

respektivisht

në nenin

3 të tij, ku

është

reflektuar

zëvendësim

i i

terminologjisë

përkatëse

në

përputhje

me

përcaktimet

sipas ligjit

nr.

139/2015

“Për

vetëqeverisjen

jen

		<p><i>vendore” dhe sugjerimit të dhënë nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë.</i></p>		
<p><b>Neni 4/2</b></p>	<p>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është shprehur që përmbajtja e nenit 4/2, që do të shtohet pas nenit 4/1 të ligjit të jetë si vijon:</p> <p><b>Neni 4/2</b> Të dhënat e RKA-së</p> <p>1. RKA-ja përbëhet nga të dhëna parësore dhe dytësore:</p> <p>Të dhëna parësore janë:</p> <p>a. elementët përbërës të adresës;</p> <p>i. Emri i bashkisë ku ndodhet ndërtesa;</p> <p>ii. Emri i njësisë administrative ku ndodhet ndërtesa;</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)</p>	<p>Vendimi i pranuar pjesërisht.</p>	<p>Formulimi për këtë dispozitë për vetë detajet e hollësishme që përmban përbërja e RKA-së do të pasqyrohet në një akt të posacem sipas parashikimit, autorizimit ligjor për këtë veprimtari, referuar propozimit të AKSHI-t. Ky reflektim është bërë sipas pikës 2 të nenit 4/2 të projektligjit, ku shprehimisht parashikohet se: “RKA përbëhet nga të dhëna parësore dhe dytësore, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Neni 4/2 është emërtuar: Përmbajtja e RKA</p> <p>Lidhur me përmbajtjen e kësaj dispozite gjithashtu janë reflektuar sugjerimet e dhëna nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)-t, për sa i përket sugjerimeve të dhëna se Regjistri Kombëtar i Adresave (RKA) është bazë të dhënash shtetërore dhe si e tillë, në mbështetje të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të dhënat e këtij regjistri konsumohen nga regjistra të tjerë elektronikë, baza të dhënash shtetërore nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.</p>

	<p>iii. Emri i qytetit ose fshatit ku ndodhet ndërtesa;</p> <p>iv. Emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/shehshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementët e mësipërm;</p> <p>v. Numri rendor i ndërtesës;</p> <p>vi. Numri i hyrjes që shërben për identifikimin e hyrjes në të njëjtën ndërtesë;</p> <p>vii. Numri i apartamentit;</p> <p>b. gjurma gjeohapësinore;</p> <p>i. Kufinj të administrative të bashkisë;</p> <p>ii. Kufinj të administrative të njësisë administrative;</p> <p>iii. Kufinj të administrative të qytet/fshat;</p> <p>iv. Segmentet rrugore urbane/rurale;</p> <p>v. Gjurmët e hyrjeve;</p>			
--	--	--	--	--

vi. Koordinatat gjeografike, gjatësi dhe gjerësi për çdo gjurmë;  
c. Kodi unik i adresës;  
ç. Pikat e intreresit;

Të dhëna dytësore janë:

- a. Ortofoto, të cilat merrren me anë të ndërveprimi t nga baza e të dhënave shtetërore Gjeoportali Kombëtar;
- b. Gjurmët e ndërtesave, të cilat merren me anë të ndërveprimi t nga baza e të dhënave shtetërore Regjistri Elektronik i Pasurive të Paluajtshme ;
- c. Kodi Postar, i cili merret nga Posta Shqiptare;



1. Dhënës informacion i janë strukturat përgjegjëse në autoritetet e territorit në nivel bashkie, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore, të cilat kryejnë përditësimin e RKA-së.

2. Këto struktura përditësojnë rregullisht të gjithë informacionin në RKA për pjesë të territorit publik dhe ndërtesat nën juridiksionin territorial të tyre.

Nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë është sugjeruar gjithashtu zëvendësimi kudo në ligj i





	<p>aksesohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit nga bazat e tjera të të dhënave shtetërore.</p> <p>3. Të dhënat jopublike të RKA-së u vihen në dispozicion subjekteve të interesuar me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.</p> <p>4. Tarifat për ofrimin e të dhënave jopublike të RKA-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.</p>			<p><i>Ndërveprimit nga bazat e tjera të të dhënave shtetërore”.</i></p> <p>Formulimi i kësaj dispozite është bërë duke marrë parasysh sugjerimin e dhënë për sa i përket Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), i cili është një bazë të dhënash dhe si i tillë, në mbështetje të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të dhënat e këtij regjistri konsumohen nga regjistra të tjerë elektronikë, baza të dhënash shtetërore nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.</p>
--	--	--	--	--

Nëpërmjet AKSHI-  
t, gjithashtu është  
sugjeruar  
riformulimi i  
dispozitës sipas  
nenit 4/4, për sa i  
përket Regjistrit  
Kombëtar të  
Adresave (RKA) si  
bazë të dhënash  
shtetërore.

Kjo dispozitë është  
riformuluar sipas  
tekstit të  
projektligjit dërguar  
për bashkërendim,  
respektivisht si  
vijon:

*“Të dhënat  
parësore, ku  
përfshihen  
elementët përbërës  
të adresës, gjurma  
gjeohapësinore,  
kodi unik i adresës  
dhe pikat e interesit  
(PI) aksesohen*

	<p><i>nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit nga bazat e tjera të të dhënave shtetërore”.</i></p>			
<p>Sipas kësaj dispozite është adresuar më tej ceshtja e emërimit të pjesëve të territorit publik, të cilat duhet të bëhen dhe në gjuhën e pakicës, për njësitë e vetëqeverisjes ku ka pakica kombëtare.</p>	<p><b>Neni 25</b> Në nenin 25, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Në bashkitë ku identifikohen pakica kombëtare, emërtimi i pjesëve të territorit publik bëhet edhe në gjuhën e pakicës”. Lidhur me propozimin për këtë dispozitë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur që kjo fajli të hiqet.</p> <p>Dhe Ministria e Drejtësisë është shprehur që ky parashikim të hiqet, duke qenë se në pikën 3 të nenit 15 të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar se “Me</p>	<p>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Vendimi i pranuar</p>	<p>Nga Ministria e Brendshme është vlerësuar që ky parashikim të jetë në ligj. Qëndrimi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbetet për t’u vlerësuar nga strukturat përkatëse të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit. Ligji për adresat adreson drejtpërdrejt ceshtjen e emërimit të pjesëve të territorit publik dhe ky parashikim konsiderohet i domosdoshëm për t’u përfshirë për njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ka pakica kombëtare. Vendimi nr. 446/2008 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të parqeve, shesheve, bulevardeve e rrugëve dhe të numërimit të ndërtesave”, është një akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar dhe adreson në mënyrë të posaçme ceshtjen e emërimit të pjesëve të territorit publik, objekt i këtij ligji.</p> <p>Aktet e tjera nënligjore që mbeten për t’u miratuar në zbatim të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, adresojnë ceshtje të tjera që nuk</p>

	<p>vendim të organe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, ku mbi 20 për qind e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet e njëjësive administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen edhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore”.</p>			<p>përkojnë me objektin e ligjit për adresat, në proces amendimi.          Kuadri ligjor në funksion të mbrojtjes së pakicave është gjithëpërfshirës dhe trajton çdo aspekt të mbrojtjes së të drejtave të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Është pranuar mendimi i dhënë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit edhe pse ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nuk ka parashikime të tilla.</p>
<p><b>Neni 25/1 e vijues</b></p>	<p>Në përmbajtje të projektligjit është reflektuar sugjerimi i katërt për riformulimin e titullit të nenit 25/3 nga “Sanksioni për procesin e emërtimit dhe numërtimit”, në “Shkelja dhe sanksioni administrativ në procesin e emërtimit dhe numërtimit”. Sipas</p>			<p>Siç parashtrohet në pjesën përmbyllëse se këto sugjerime jepen me qëllim që</p>

	<p>këtij propozimi është riformuluar neni 32 i ligjit, gjithashtu i emërtuar me titullin sipas propozimit “Shkelja dhe sanksioni administrativ në procesin e emërimit dhe numërimit”.</p> <p>Sugjerimet e mëtejshme, për formulimin e nenit 25/3 nuk janë reflektuar. Neni 25/3 në përmbajtje të projektligjit të dërguar për mendim është hequr. Nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve, është sugjeruar riformulimi i kësaj dispozite, respektivisht si vijon:</p> <p><i>“a) Shkelja ose morespektimi i dispozitave të parashikuara në pikën 1 të nenit 25/1 dhe pikën 1 të nenit 25/2 të ligjit nga bashkitë, në të cilat rezultojnë</i></p>	<p>Kjo ceshtje është reflektuar dhe në komentet e dhëna nga Ministria e Drejtësisë, të cilat janë reflektuar.</p>	<p>Vendimi i pranuar pjesërisht</p> <p>Vendimi i pranuar</p>	<p>ndryshimet e propozuara të jenë në pajtim me përcaktime sipas ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 <i>“Për kundravajtjet administrative”</i>, përkatësisht neni 6, neni 8 dhe neni 9 i Kodit të Procedurës Civile, neni 510, ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 <i>“Për gjendjen civile”</i>, të ndryshuar, neni 65, për këtë dispozitë është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Është reflektuar</p>
--	--	---	--	--

	<p><i>pjesë të territorit publik të paemërtuara dhe të panumërtuara me tabelat përkatëse dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.</i></p> <p><i>b) Masa e gjobës e parashikuar në pikën “a” vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile për kryetarin e bashkisë.</i></p> <p><i>c) Sanksioni administrativ, përbën titull ekzekutiv zbatohet për çdo pjesë të territorit publik të paemërtuar sipas të gjithë elementeve të adresës dhe të panumërtuar dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre”.</i></p>			
<p><b>Neni 8</b> Lidhur me nenin 8, ku parashikohet shtimi i neneve 25/1, 25/2 dhe 25/3, pas nenit 25 me këtë përmbajtje: Neni 25/1 <b>Procesi i emërtimit</b></p>	<p>Dispozitat janë përmbledhur në dy nene që shtohen pas nenit 25, neni 25/1 dhe 25/2, që specifikisht i referohen procesit të emërtimit dhe numërtimit, respektivisht si vijon:</p>	<p>Kjo veprimtari është identifikuar si veprimtari konkrete, referuar dhe sugjerimeve të</p>	<p>Vendimi i pranuar</p>	<p>Është reflektuar njëkohësisht sugjerimi i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë</p>

<p>1. Bashkia vendos tabelat e emërtimit për zonën e qarkullimit civil brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i këtij ligji, sipas adresës në RKA.</p> <p>2. Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki identifikon zonat e qarkullimit civil të paemërtuara.</p> <p>3. Bashkia raporton ecurinë e procesit të emërtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të</p>	<p><b>“Neni 25/1 Procesi i emërtimit</b></p> <p>1. Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore identifikojnë zonat e qarkullimit civil të paemërtuara dhe informojnë kryetarin e bashkisë.</p> <p>2. Bashkia vendos tabelat e emërtimit për zonën e qarkullimit civil brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i këtij ligji, sipas informacionit në RKA.</p> <p>3. Kryetari i bashkisë kontrollon dhe raporton për ecurinë e procesit të emërtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.</p> <p><b>Neni 25/2</b></p>	<p>Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë për zëvendësimin kudo në ligj të togfjalëshit “seksionet/zyrat e urbanistikës”, me togfjalëshin “strukturat përgjegjëse në autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel bashkie si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore”.</p> <p>Përgjegjësi kryesor për këtë proces është ngarkuar kryetari të bashkisë, i</p>	<p>Vendimi i pranuar pjesërisht</p>	<p>Është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë.</p> <p>Sugjerimi i dhënë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk është reflektuar, pasi është vendosur se shpenzimet për procesin e numërtimit do të përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.</p>
---	---	---	-------------------------------------	---

<p>Gjendjes Civile.</p> <p>Neni 25/2</p> <p><b>Procesi i numërtimit</b></p> <p>1. Bashkia kontrollon mbarëvajtjen e procesit të vendosjes së tabelave të numërtimit fizik të ndërtesave, të hyrjeve dhe apartamenteve.</p> <p>2. Pronari i ndërtesës vendos tabelën e numërtimit brenda brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i rregullave për vendosjen e tabelës së numërtimit.</p> <p>3. Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki identifikon ndërtesat, hyrjet dhe apartamentet e panumërtuara.</p> <p>4. Bashkia raporton ecurinë e</p>	<p><b>Procesi i numërtimit</b></p> <p>1. Strukturat përgjegjëse në autoritetet për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore identifikojnë ndërtesat, hyrjet dhe apartamentet e panumërtuara dhe informojnë kryetarin e bashkisë/njesisë administrative.</p> <p>2. Bashkia/njësia administrative vendos tabelat numërtimit fizik të ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i këtij ligji, sipas informacionit në RKA.</p> <p>3. Kryetari i bashkisë/njesisë administrative kontrollon dhe raporton për ecurinë e procesit të numërtimit në Drejtorinë e</p>	<p>cili duhet të kontrollojë ecurinë e tij dhe të raportojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për mbarëvajtjen e tij.</p> <p>Në të njëjtën llogjikë renditje është parashikuar formulimi për procesin e numërtimit, që do të ndiqet nga strukturat përgjegjëse në autoritetet për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeveris</p>		
--	--	---	--	--



<p>procesit të numërtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.</p> <p>Neni 25/3</p> <p><b>Sanksioni për procesin e emërtimit dhe numërtimit</b></p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile vendos masë administrative në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për kryetarin e bashkisë, në të cilën rezultojnë pjesë të territorit publik të paemërtuara dhe të panumërtuara me tabelat përkatëse.</p> <p>2. Sanksioni, i cili përbën titull ekzekutiv zbatohet për çdo pjesë të territorit publik të paemërtuar sipas të gjithë elementëve të adresës dhe të panumërtuar.</p>	<p>Përgjithshme të Gjendjes Civile.”</p> <p>Nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, është dhënë sugjerim lidhur me vendosjen e tabelës së numërtimit brenda 90 (nëntëdhjetë) nga miratimi i rregullave për vendosjen e tabelës së numërtimit, sipas adresës në RKA, nga:</p> <p>a) pronari i banesës, për apartamentin, apo objektin familjar që ka në pronësi;</p> <p>b) zhvilluesi, për hyrjet, si dhe godinat e destinuar për shitje (shumë familjare);</p>	<p>jes vendore.</p> <p>Sanksioni administrativ për mosrealizimin e këtyre dy procesve është spostuar sipas dispozitave të nenit 10 të projektligjit të dërguar për bashkërendim sipas ndryshimeve në nenin 32 të ligjit ekzistues, të emërtuar me titullin “Shkelja dhe sanksioni administrativ në procesin e emërtimit dhe numërtimit”, përmbajtja e të cilit është</p>		
--	---	--	--	--

ndryshuar  
si më  
poshtë, me  
këtë  
përmbajtje:

1. Shk  
elja  
ose  
mos  
resp  
ekti  
mi i  
dety  
rimi  
t  
ligj  
or,  
nga  
pers  
onat  
për  
gjeg  
jës  
sipa  
s  
nen  
eve  
25/  
1  
dhe  
25/  
2 të  
këti  
j  
ligji  
për  
bën  
kun  
dër

		vajt je adm inist rati ve dhe dën ohet me gjo bë në vler ën 10 000 (dhj etë mij ë) lekë për çdo pjes ë të terri torit pub lik të pae mër tuar , bule var d, rrug ë,		
--	--	--	--	--

rrugicë, shesh dhe park, si dhe për çdo ndërtesë, hyrje, apartamente të panumërtuar.

Sugjerimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke sqaruar kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm i Gjendjes Civile, i

cili i vendos gjobë kryetarit të bashkisë/njësisë administrative për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni në vlerën 10 000 lekë.

Është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në dispozitën sipas pikës 2 të nenit 25/3, ku shprehimisht parashikohet se sanksioni përbën titull

		ekzekutiv, duke përcaktuar qartësisht se sanksioni i cili përbën titull ekzekutiv zbatohet për çdo pjesë të territorit publik të paemërtuar sipas të gjithë elementëve të adresës dhe të panumërtuar.		
<p><b>Neni 28</b> Në nenin 28, bëhen këto ndryshime: “1. Ky nen emërtohet me titullin: “Shpenzimet për procesin e emërimit dhe numërimit”; 2. Neni 28 ndryshon me këtë përmbajtje: “Shpenzimet për vendosjen e tabelave të emërtimeve të</p>	<p>Sugjerimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për harmonizimin e dispozitave në nenin 9, nuk është reflektuar.</p> <p>Është dakordësuar që shpenzimet në tërësi për adresimin e pjesëve të territorit publik, që i referohen vendosjes së tabelave të emërtimeve të</p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p> <p>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</p>	<p>Vendimi i refuzuar</p>	<p>U dakordësua që për këto shpenzime të numërimit të brendshëm të ndërtesave të mos ngarkohej pronari i ndërtesës, si në versionin fillestar, por vetë organet e vetëqeverisjes vendore, duke qenë se janë drejtpërdrejt organet e ngarkuara me kompetencat për planifikimin e dhe zhvillimin e territorit.</p> <p>Siç edhe më lart e parashtruam, sipas dakordësisë së arritur, shpenzimet për procesin e emërimit dhe numërimit si për objekte njëfamiljare dhe për godina</p>

<p>bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe të numërtimit të ndërtesave publike dhe private, sipas hyrjeve dhe apartamenteve në përbërje të tyre përballohen nga buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.</p>	<p>bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe të numërtimit të ndërtesave publike dhe private në përbërje të tyre të përballohen nga buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe jo nga pronari i ndërtesës siç ishte parashikuar në draftin fillestar.</p> <p>Lidhur me ndryshimet në nenin 28 të ligjit është shprehur dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit, sipas sugjerimit të mëposhtëm: Në nenin 28, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Shpenzimet për tabelat e numërtimeve përballohen nga pronari, kur bëhet fjalë për objekte njëfamiljare dhe nga zhvilluesi, kur bëhet fjalë për godina të destinuara për shitje (shumë familjare).</p>		<p>Vendimi i refuzuar</p>	<p>të destinuara për shitje (shumë familjare) do të përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.</p>
---	--	--	---------------------------	--

Janë shfuqizuar neni 29 dhe 33 të ligjit			Vendimi i pranuar	
Neni 33/1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator është shprehur për harmonizimin e dispozitave për nenin 25/2, ku parashikohet afati 90 (nëntëdhjetë) ditor i vendosjes së tabelave të numërtimit fizik të ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve të panumërtuara nga miratimi i këtij ligji sipas informacionit në RKA, dispozitë e cila është harmonizuar sipas përmbajtjes së nenit 33/1, që parashikon hyrjen në fuqi të akteve nënligjore që do të miratohen, brenda 3 (tre)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullator e dhe Përputhshmërisë, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator	Vendimi i pranuar	Janë marrë parasysh sygjërimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, të cilët janë shprehur parimisht dakord, për sa kohë janë reflektuar dhe sqaruar komentet e këtij institucioni lidhur me mbulimin e kostove financiare dhe ndryshimet e nenit 28 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, për sa i përket sugjerimit të dhënë për afatin e miratimit të projektligjit sipas nenit 8 të tij, ku shprehimisht parashikohet se: <i>“Rregullat për vendosjen e tabelës së numërtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”</i> , për të cilin në dispozitën përkatëse sipas nenit 12 të projektligjit është vendosur afati 3 (tre) mujor i miratimit të projektakteve në zbatim të tij. Me parashikimin e këtij afati konsiderojmë se vendosja e këtij afati qartëson këtë proces, detyrim të bashkisë për vendosjen e tabelave të numërtimit fizik të ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve.  Përcaktimin e afatit të shprehur 90 (nëntëdhjetë) ditor, e konsiderojmë të mjaftueshëm për bashkërendimin e procesit që do të ndërmerret nga bashkia / njësia administrative për procesin e vendosjes së tabelave të numërtimit



	muajve nga hyrja në fuqi e tij.			<p>fizik të ndërtesave, hyrjeve, apartamenteve, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga miratimi i këtij ligji, sipas informacionit në RKA.</p> <p>Është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për harmonizimin e këtyre dispozitave.</p>
--	---------------------------------	--	--	---